



BASHKIA MIRDITË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1706 Prot

Rrëshen, më 15. 04. 2026

R A P O R T

I PERFORMANCËS TË KËSHILLIT BASHKIAK MIRDITË, PËR VITIN 2025

Paraqitur për njohje e shqyrtim, në mbledhjen e datës 24 Prill 2026, të Këshillit bashkiak Mirditë.

Të nderuar këshilltarë!

Këshilli Bashkiak Mirditë, për vitin 2025, ka patur bashkëpunim të mirë dhe punë intensive në vendimmarrje, duke marrë parasysh edhe kërkesat e paraqitura nga qytetarët për t'ju dhënë zë atyre, bazuar në ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar dhe Vendimin nr. 35, datë 10.04.2020, të Këshillit Bashkiak Mirditë, "Për miratimin e Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkisë Mirditë"

Këshilli Bashkiak, ka tre role kryesore:

- 1. Përfaqësues,**
- 2. Vendimmarrës,**
- 3. Mbikëqyrës**

Për secilin nga këto role të Këshillit Bashkiak po ju citojmë aktivitetet e kryera si më poshtë vijon:

1. Në lidhje me rolin përfaqësues të Këshillit për vitin 2025;

Është synuar një komunikim dhe transparencë e vazhdueshme me komunitetin, duke publikuar në rrjetin social Facebook dhe në faqen zyrtare; <https://bashkiamirdite.gov.al/sq/keshilibashkiak>, në kohën e duhur njoftimin për çdo mbledhje duke vënë në dispozicion të gjitha projekt-vendimet e rendit të ditës

Konsultimet Publike – viti 2025

Këshilli Bashkiak Mirditë ka organizuar e zhvilluar konsultimet publike për projekt-vendimet në pëpëthje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi

U realizuan Konsultimeve Publike gjatë vitit 2025, si më poshtë vijon;

- Plani i Buxhetit Afatmesëm 2026-2028
- Miratimin e Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe Buxhetit Vjetor 2027

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

- Paketën Fiskale Vendore të Bashkisë Mirditë për vitin 2026
- Buxheti i Bashkisë për vitin 2025 dhe Dokumentit Përfundimtar të Projektbuxhetit Afatmesëm 2026-2028

Takimet publike janë mbajtur dhe pasqyruar në faqen zyrtare dhe rrjetin social FB të Bashkisë/Këshillit Bashkiak Mirditë;

- Përfaqësues të Këshillit Bashkiak Mirditë,
- Qytetarë dhe banorë të njësive administrative respektive të Bashkisë
- Përfaqësues të Grupeve të Interesit

Gjatë takimeve janë respektuar procedurat në zbatim të ligjit duke përfshirë;

- Mbajtjen e procesverbaleve,
- Listat e prezencës,
- Dokumentimin me foto

2. Në lidhje me rolin vendimmarrës, janë kryer aktivitetet si më poshtë vijon;

Gjatë vitit 2025 janë relaizuar në total **13** mbledhje Këshilli, **12** prej tyre mbledhje të radhës dhe **1** mbledhje jashtë radhe me **kërkesë të Grupit të Këshilltarëve të Majtë**

Komisionet e Këshillit Bashkiak janë mbledhur **15** (pesëmbëdhjetë) herë

- **Komisioni i Ekonomisë dhe Financës;** datë **21.01.2025**, 7 (shtatë) anëtarë, datë **30.05.2025**, 7 (shtatë), datë **28.07.2025**, 4 (katër) anëtarë, datë **29.09.2024**, 5 (pesë) anëtarë, datë **29.10.2025**, 5 (pesë) anëtarë, datë **25.11.2025**, 4 (katër) anëtarë datë **09.12.2025**, 4 (katër) anëtarë datë **29.12.2025**, 5 (pesë) anëtarë
- **Komisioni i Bujqësisë, Shëndetit Publik dhe Pyjeve;** datë **19.02.2024**, 4 (katër) anëtarë nga 5 (pesë) datë **24.04.2024**, 3 (tre) anëtarë nga 5 (pesë)
- **Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve;** datë **28.07.2025**, 3 (tre) anëtarë
- **Konisioni i Arsimit, Sportit dhe Turizmit;** datë **29.12.2025**, 3 (tre) anëtarë
- **Komisioni i Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës;** datë **21.01.2025**, 5 (pesë) anëtarë datë **17.06.2025**, 3 (tre), **29.12.2025**, 3 (tre) anëtarë + Kryetari i Këshillit

Gjithësej janë miratuar **109** vendime nga Këshilli Bashkiak, nga të cilat:

- **35** vendime - **Akte me Karakter Normativ**, të konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë
- **74** vendime - **Akte me Karakter Individual**, (akte që nuk dërgohen për konfirmim te Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë)

Gjithashtu, kemi miratuar planin e punës të shoqëruar me planin e konsultimeve dhe buxhetin përkatës të dedikuar vetëm për Këshillin, me qëllim realizimin e gjithë aktiviteteve të parashikuara

Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak Mirditë, janë transmetuar **live në Facebook**, çka ka bërë që komuniteti të ndjekë direkt mbledhjet

Është realizuar një tryezë pune;

- ✓ **Tryezë Pune;** Bashkëpunimi ndërinstitucional për forcimin e ligjshmërisë dhe transparencës në funksionimin e |Këshillave Bashkiakë Mirditë & Lezhë dhe

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

institucionin e Prefektitme suportin e projektit “Bashki të Forta” (BtF), Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

- ✓ **Qëllimi**, forcimin e bashkëpunimit dhe rritjen e qartësisë institucionale ndërmjet tyre. Mbështetur në raportin e vlerësimit të situatës, hartuar nga IDM në qershor 2025 për 6 Këshilla Bashkiakë (Shijak, Shkodër, Lezhë, Mirditë, Dibër, Kukës), janë evidentuar problematika të ndryshme në kategorizimin dhe trajtimin e **akteve normative dhe individuale**, si dhe në cilësinë e dokumentacionit shoqëruar që përcillet për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve të këshillave bashkiakë.

Në këtë kontekst, synohet të diskutohet:

- roli i institucioneve mbështetur në legjislacionin dhe rregulloret përkatëse;
- çështje të përmirësimit të përmbajtjes së relacioneve dhe dokumentacionit shoqëruar të vendimeve
- ✓ Alenca e Grave Këshilltare Mirditë, finalizoi nismën; **“Eliminimi i tarifës ditore të ushqimit për fëmijët e çerdheve dhe kopshteve me nënat kryefamiljare”**, që u pëfshi dhe miratua në vitin buxhetor 2025 të Bashkisë Mirditë e në vazhdim
- ✓ Alenca e Grave Këshilltare Mirditë, realizoi projektin; **“Ngjyrat e Barazisë”** në bashkëpunim me Agjencinë e Arsimit, Sportit dhe Ndihmës Sociale, Bashkia Mirditë, në shkollat;
 - ✚ Shkolla 9-vjeçare “Pashko Vasa” Rrëshen
 - ✚ Shkolla 9-vjeçare “Nënë Tereza” Rrëshen
 - ✚ Shkolla 9-vjeçare Rubik
 - ✚ Gjimnazi Rrëshen

Vlen të përmendet, puna e palodhur dhe e suksesshme Komisionit të Barazisë Gjinore, Gartë Këshilltare, Znj. **Marjana Molla**, Znj. **Marjana Prenga** & Znj. **Rigerta Loku** dhe mbështetja financiare nga buxheti i Bashkisë Mirditë

3. Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit;

Nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezauruara nga ana e Këshilltarëve në drejtim të administratës, në rastin e shqyrtimit të projekt-vendimeve të propozuara nga ekzekutivi

Këshilli Bashkiak, duhet të kërkojë administratës, raporte sqaruese, çdo tre muaj, mbi ecurinë dhe ekzekutimin e vendimeve të miratuara nga Këshilli

- **Të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak, janë publikuar në faqen zyrtare Bashkisë Mirditë, <https://bashkiamirdite.gov.al> dhe janë të aksesueshëm pa pagesë nga çdo qytetar**
- **Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak, janë publikuar në faqen zyrtare <https://www.youtube.com/KeshilliBashkiakMmirdite> ku aksesohen pa pagesë nga çdo qytetar**

Është pasuruar në faqen zyrtare të Bashkisë Mirditë, informacionet e Këshillit Bashkiak për publikun nëpërmjet kartelave/tabelave të mëposhtëme:

- Kryetari i Këshillit - kontaktet
- Sekretari i Këshillit - kontaktet
- Anëtarët e Këshillit Bashkiak - kontaktet
- Kryetarët e Fshatrave të Bashkisë - kontaktet
- **5** Rregulloret e Këshillit Bashkiak
- Kalendar i Konsultimit Publik
- Njoftimi i konsultimit publik
- Vendim i miratimit të planit të aktiviteteve dhe buxhetit të këshillit (Plan+buxhet këshilli)
- Rregjistri i kërkesë ankesave
- Rregjistri i brendshëm i peticioneve
- Rregjistri i mbledhjeve të këshillit
- Konsultime Publike
- Raportet e Komisioneve të Këshillit Bashkiak

Nga Sekretariati i Këshillit është vënë në zbatim kërkesat e ligjit për njoftimet publike (si në faqen zyrtare të Bashkisë, Drejtorëve të bashkisë), në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe Rregulloren e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Mirditë, por në të ardhmen do të bëhet e mundur jo vetëm njoftimi në faqen e Bashkisë apo në media vendore por edhe njoftimeve e shpalljeve në të gjitha njësitë administrative e lagjet e qytetit, ku për këtë është e nevojshme mbështetja nga nëpunësit e njësive administrative.

Gjithashtu në çdo mbledhje plenare të radhës është lënë një hapësirë për pyetje nga komuniteti (kërkesa apo ankesa), që janë përcjellë përmes pyetjeve që kanë bërë Këshilltarët drejtuar administratës së Bashkisë, të cilat kanë marrë përgjigje të drejtëpërdrejtë nga administrata e bashkisë.

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen; gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimit dhe dhënies me qira të pronave, miratimi i standarteve e rregulloreve etj. me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimarrje të komunitetit.

Administratorët e lagjeve dhe të njësive administrative, kryesitë e fshatrave, këshillat komunitare, duhet të bëhen pjesë e organizimit e mbështetjes së dëgjësive publike, ku nëpërmjet posterave, anketave të ndryshme do të bëhet e mundur tërheqja e mendimit të komunitetit dhe pjesëmarrja e tyre në vendimarrje

Del si detyrë që çdo këshilltar; për aktet normative, të cilat do të diskutohet dhe vendoset në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të

Për sa më sipër, vlerësojmë përvojën pozitive dhe ndërkohë kërkojmë plane tuaja për dëgjesa në zonat ku banoni apo jeni caktuar për të kryer detyrën e këshilltarit

Falenderimet, shkojnë për;

- Falenderojmë Kryetarin e Bashkisë Mirditë **Z. Albert Mëlyshi**, për bashkëpunimin dhe prezencën e tij, veçanarisht në mbledhjet e Komisioneve të Këshillit Bashkiak

- Falenderojmë, administratën e Bashkisë Mirditë dhe mbështetjen që i kanë dhënë Sekretariatit të Këshillit dhe në veçanti, Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave, Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit, Agjencinë e Arsimit, Sportit dhe Ndihmës Sociale, Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave, Protokollin dhe Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun
- Falenderojmë, Asistenten e Këshillit Bashkiak, Znj. **Lindita Zefi**, për punën, korrektesën dhe përkushtimin e saj, në mbarëvajtjen e dokumentimin e saktë të mbledhjeve të Komisioneve të Përhershme dhe të Këshillit Bashkiak Mirditë
- Falenderojmë Znj. **Artilda Laska**, për publikimet e gjithë vendimeve dhe dokumenteve shoqërues në web-in e Bashkisë dhe të palodhurin Z. **Edmod Dodaj** për transmetimet online të mbledhjeve të Këshillit në mënyrë korrekte dhe profesionale

Ndërveprimi i Këshillit Bashkiak me qytetarët, në rrjetet sociale, të nxjerra në mënyrë garfikike dhe “Analiza e statistikave të përgjithshme për faqen e Këshillit Bashkiak Mirditë”, pjesë përbërse e këtij raporti, bashkëlidhur

Faleminderit!

Hartoi raportin:

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK


Gaspër TOPOLLAJ



Custom: Jan 1 - Dec 31

181,328 Views

-- from previous 365 days



Viewers

35,574

3-second views

9,467

1-minute views

By content type

Followers Non-followers

Reel

38.2%

Photo

24.2%

Link

21.7%

Live

8.4%

Multi photo

7.7%

By followers vs non-followers



47.1%

52.9%


Non-followers

Followers

Custom: Jan 1 - Dec 31

1,489 Total followers

+8.3% from previous 365 days



111

Net follows




53

Unfollows

Net follows by content type


Lifetime



Age & gender


Lifetime

● Women ● Men ● Unknown




Cities

Lifetime



Countries


Lifetime



Custom: Jan 1 - Dec 31

181,328 Views

-- from previous 365 days



--

Viewers



35,574

3-second views



9,467

1-minute views

By content type

Followers Non-followers

Reel



Photo



Link



Live



Multi photo



By followers vs non-followers



47.1%

Non-followers

52.9%

Followers

ANALIZA E PERFORMANCËS - VITI 2025

(FACEBOOK)

KËSHILLI BASHKIAK MIRDITË

Mirdita tregon një dinamikë specifike komunikimi, ku dominon videoja dhe një interes i lartë për përmbajtjen informative vizuale.

1. Shikueshmëria dhe Arritja (Reach)

- **Volumi i Shikimeve:** Gjatë vitit 2025, faqja ka arritur në **181,328 views**. Kjo shifër është mjaft e lartë, duke treguar një penetrim të fortë në publikun mirditor dhe më gjerë
- **Cilësia e Shikimit:** * **35,574** shikime janë mbi 3 sekonda.
- **9,467 shikime janë mbi 1 minutë.** Kjo shifër e dytë është mjaft mbresëlënëse (*pothuajse dyfishi i Lezhës*), gjë që tregon se audienca e Mirditës ka një durim dhe interes më të madh për të ndjekur mbledhjet apo videot e gjata në tërësi.
- **Besnikëria e Audiencës:** Për dallim nga shumë faqe institucionesh, këtu **52.9%** e shikimeve vijnë nga ndjekësit (Followers). Kjo tregon një bërthamë qytetare shumë besnike që e përdor faqen si burim primar informacioni.

2. Angazhimi dhe Ndërveprimi (Interactions)

- **Vëllimi i Ndërveprimeve:** Janë regjistruar **3,334 ndërveprime** totale, me një rritje prej **+28.5%** krahasuar me vitin paraprak.
- **Shpërndarja e Interaksionit:**
 - **Reagimet:** **88.7% (2,958)**
 - **Komentet:** **9.4% (312)**. Vlen të theksohet se numri i komenteve këtu është dukshëm më i lartë se në raste të ngjashme, duke dëshmuar një komunitet që kërkon llogaridhënie ose shpreh mendime aktive.
 - **Shpërndarjet (Shares):** **64**.
- **Dominimi i Ndjekësve:** Pjesa dërrmuese e ndërveprimeve (**60.8%**) vjen nga ndjekësit e faqes, duke konfirmuar se angazhimi është kryesisht organik dhe lokal.

3. Analiza sipas Llojit të Përmbajtjes

- **Reels (Motorri i Rritjes):** Përmbajtja Reels është dominuese, duke gjeneruar **38.2%** të shikimeve dhe **40.8%** të angazhimit total. Gjithashtu, **61.3%** e ndjekësve të rinj janë fituar falë këtij formati.
- **Transmetimet Live:** Megjithëse zërin vetëm **8.4%** të shikimeve, ato mbajnë **24.6% të peshës së ndërveprimeve**. Kjo do të thotë se njerëzit ndërveprojnë masivisht gjatë kohës që Këshilli është Live.
- **Fotot:** Kanë një peshë të konsiderueshme në shikueshmëri (**24.2%**), duke treguar se njoftimet grafike mbeten një mjet efikas komunikimi në Mirditë.

4. Demografia dhe Gjeografia e Audiencës

- **Shtrirja Urbane:** Audiencia është e ndarë pothuajse barabartë mes **Rrëshenit (36.7%)** dhe **Tiranës (36.4%)**. Kjo pasqyron lëvizjen demografike të popullsisë së Mirditës drejt kryeqytetit, por që ruajnë interesin për vendlindjen. Lezha kontribuon me **10.4%**.
- **Shtetet:** Pas Shqipërisë (**79.6%**), diaspora mirditore në **Itali (8.1%)** dhe **Greqi (3.1%)** përbën pjesën kryesore të ndjekësve jashtë vendit.
- **Profili i Përdoruesit:**
 - Grupmosha dominuese: **35-44 vjeç (26.2%)**, e ndjekur ngushtë nga **25-34 vjeç** dhe **45-54 vjeç**.

Gjinia: Dominim i theksuar i **burrave**, të cilët përbëjnë mbi **70%** të audiencës aktive në të gjitha grupmoshat.

Përfundime Strategjike

1. **Vlera e Transmetimeve Live:** Për Mirditën, videot "**Live**" janë "kalit i betejës" për angazhim. Çdo mbledhje live po gjeneron komente dhe pyetje që kërkojnë vëmendje administrative.
2. **Ura me Tiranën dhe Diasporën:** Duke qenë se mbi **40%** e audiencës nuk jeton fizikisht në Rrëshen (por në Tiranë apo Itali), përmbajtja duhet të jetë e orientuar edhe drejt transparencës për investimet dhe planet që prekin pronat apo familjarët e tyre në Mirditë.
3. **Potenciali i Formateve të Shkurtra:** Meqenëse Reels sjellin shumicën e ndjekësve të rinj, përdorimi i tyre për të përmbledhur vendimet e Këshillit në 60 sekonda do të ishte tejet efektiv.